



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:009912
Datë: 16.08.2018
Numri i dokumentit: 00103864

P.nr.489/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i përgjithshëm divizioni penal. si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari individual Adem Shabani me zurtaren Ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga Ferizaj rruga "[REDACTED]", për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.705-9/18 të datës 28.03.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.16.08.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Bahri Hyseni, përfaqësuesi i të dëmtuarës [REDACTED] me autorizim dhe i akuzuari [REDACTED], të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED] nga Ferizaj rruga "[REDACTED]", i lindur me datë [REDACTED] nga i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i pesë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri i pa denuar deri me tani mbrohet në liri, me numër personal [REDACTED]. -

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

-me datën 07.11.2017, në shtëpinë e tij, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme, vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm gjatë

kontrollimit nga ana e punëtorëve të KEDS-it, është hasur duke vjedhur energjinë elektrike me çrast ka bërë ndërhyrje të paautorizuar duke u kyçur direkt në rrjetin kryesor të furnizimit në KPO me ndërpres 1-0-2 jashtë pikës matëse duke anashkaluar njehsorin elektrik, me çrast të dëmtuarës KEDS-it, Disktrikti në Ferizaj i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 320,82 Euro,-

-me të cilën kreu veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe neneve 4, 7, 17, 23, 41, 42, 43, 51, 52, dhe 73 të KPK-së dhe nen. 365 të KPPK-së e:

GJYKON DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarin [REDAKTUAR] i shqipton dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) Euro dhe me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimet e shqiptuara me gjobë dhe me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë nuk do të kryej veprë tjetër penale.

Obligohet i pandehuri që në emër të kërkesës pasurore juridike KEDS-it distrikti në Ferizaj ti paguaj shumën prej 320,82 Euro,-

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, dhe taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nen paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të kriminit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.705-9/18 të datës 28.03.2018, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga Ferizaj rruga "[REDAKTUAR]", për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPRK-së me dt.16.08.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit përfaqësuesi i të dëmtuarës dhe i akuzuari.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPRK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se

i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar për veprën penale që akuzohet ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë si në dispozitiv të aktakuzës dhe është e vërtetë se është njoftuar nga bashkëshortja e tij se në shtëpi kanë ardhur punëtorët e KEDS-it dhe kanë bërë kontrollimin e shtëpisë me furnizim të energjisë elektrike dhe gjatë kontrollimit kanë hasur se jashtë njehsorit elektrik ka qenë lidhur një kabllo e energjisë elektrike dhe për dëmin që i ka shkaktuar ka arritur marrëveshje me KEDS-in dhe është duke e paguar dhe atë me faturën e rregullt të shpenzimit të energjisë elektrike ku deri tani ka paguar shumën prej 170 Euro ku në vazhdim të muajve do ta shlyej gjithë borgjin që i ka shkaktuar të dëmtuarës, kërkon falje publike për veprën që e ka kryer, është hera e parë që ndeshet me ligjin dhe premtos se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla, ëshë baba i pesë fëmijëve i pa punë i gjendjes së dobët ekonomike i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të marr për bazë theksimet e cekura dhe ti shqiptoj një dënim sa ma të lehtë dhe ka premtuar se më nuk do të përsëris veprime të tilla.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPRK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurorori i shtetit Bahri Hyseni, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit dhe pranimi korrespondon edhe me provat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe kërkon nga gjykata që të njëjtin ta pranoj si të tillë.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës Distrikti në Ferizaj [REDAKTUAR] ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe i bashkangjitet ndjekjes penale dhe të akuzuarin ta obligoj gjykata që ta shlyej në tërësi dëmin që i ka shkaktuar i precizuar në dispozitiv të aktakuzës.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vetëtuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale nga procesverbali i konstatimit të gjendjes faktike me numër 2250933 të datës 07.11.2017, fatura KES/CO, mbi llogaritjen e dëmit të shkaktuar me nr.1714399 të datës 08.11.2017, foto dokumentacioni mbi mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për veprën e kryer ka theksu se më nuk do të përsëris veprime të tilla, i pa pun gjendjen jo të mirë ekonomike, baba i pesë fëmijëve, të dëmtuarës një pjesë të dëmit të shkaktuar i ka paguar dhe ka premtuar se në të ardhmen do ta paguaj në tersi burgjin që i ka të dëmtuarës , tani çdo gjë është në rregull me furnizim me energji elektrike në shtëpi përmes njehsorit elektrik, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqipton dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimit duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPPRK-së ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës KEDS-it Distrikti në Ferizaj, t'a paguaj dëmin që e ka shkatuar.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nënpar. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.489/18 me datë 16.08.2018

Zyrtarja ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.